



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 11

Tiranë – E hënë, 30 mars 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Kërkesë e Drejtorisë së Ndihmës
Juridike Falas
nr. 65/1, datë 24.3.2020

Për shtyrjen e afatit të pranimit të aplikimeve për dorëzimin e dokumentacionit për aplikim për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.....

3



NJOFTIM
NR. 65/1, DATË 24.3.2020

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË
PRANIMIT TË APLIKIMEVE PËR
DORËZIMIN E
DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM
PËR AUTORIZIMIN E
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE
QË DO TË OFROJNË NDIHMË
JURIDIKE PARËSORE TË
GARANTUAR NGA SHTETI

Me shkresën tonë nr. 65 prot., datë 12.2.2020, kemi kërkuar publikimin e njoftimit në faqen tuaj zyrtar të thirrjes “Për hapjen e aplikimeve për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore”. Njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare më datë 26.2.2020. Referuar njoftimit, një pjesë e dokumentacionit të kërkuar duhet të sigurohet nga OJF-të nëpërmjet gjykatës. Meqenëse veprimtaria e gjykatave është pezulluar me vendim të KLGJ-së, vendimi nr.127, datë 10.3.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të vështirësive në sigurimin e dokumentacionit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi shtyerjen e afateve të pranimit të aplikimeve.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 6.2.2019, ndër të tjera përcaktohet se: “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, njofton publikisht OJF-të për hapjen e procedurave të aplikimit për marrjen e autorizimit për ofrimin e ndihmës parësore. Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të këtij institucioni (Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas), të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.”

Sa më sipër, lutemi publikim e njoftimit për shtyerjen e afatit të aplikimeve.

Për shkak të gjendjes së krijuar nga përhapja e sëmundjes infektive COVID-19, si dhe vështirësisë në sigurimin e dokumentacionit si pasojë e pezullimit të veprimtarisë së gjykatave me vendim të KLGJ –së, vendimi nr.127, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton shtyerjen e afatit të aplikimeve për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore deri në një njoftim të dytë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTOR I NDIHMËS JURIDIKE FALAS
(NË MUNGESË)
SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE
Ani Grizhja

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.